



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**



Titulli i Modullit : Gjuhë Italiane për mjekësinë dentare

Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Italisht

Kohëzgjatja e programit të modullit: 40 orë

Nr. i krediteve: 4 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Nëpërmjet metodave aktive dhe pjesëmarrëse. Aktiviteteve mësimore në formën e punës praktike.

PËRMBLEDHJE E MODULLIT:

Ky modul formimi është hartuar me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive komunikative dhe njohurive teknike të profesionistëve në fushën e mjekësisë dentare.

Në një mjedis gjithnjë e më global, njohja e gjuhëve të huaja, veçanërisht e gjuhës italiane, është thelbësore për ofrimin e një kujdesi cilësor dhe efektiv për pacientët.

Çdo temë e këtij moduli është projektuar për të ofruar një kombinim të njohurive teorike dhe praktikave të aplikueshme, të cilat janë të rëndësishme për profesionistët në fushën e stomatologjisë.

Njohja e terminologjisë specifike dhe zhvillimi i aftësive komunikative në gjuhën italiane janë të domosdoshme për të krijuar një marrëdhënie të mirë mjek-pacient. Pjesëmarrësit do të mësojnë si të komunikojnë me qartë dhe efektivisht në situata të ndryshme klinike, do të përfitojnë nga një përmirësim i ndjeshëm në kualifikimet e tyre profesionale gjë që do t'i japë atyre një avantazh të rëndësishëm në tregun e punës dhe do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dentare.

REZULTATET E TË NXËNIT:

-përmirësimi i komunikimit në gjuhën Italiane me klientët;

- përvetësimi i aspekteve gjuhësore;

- përvetësimi i terminologjisë së duhur për temat e trajtuara në fushën e mjekësisë dentare;
- të shprehurit me shkrim dhe me gojë lidhur me temat e trajtuara

OBJEKTIVAT E MODULIT:

- përmirësimi i komunikimit në gjuhën italiane me klientët;
- përvetësimi i aspekteve gjuhësore;
- përvetësimi i terminologjisë së duhur për temat e trajtuara në fushën e mjekësisë dentare.